



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 1208/23 Datë: 15/09/2023

Në mbështetje të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), nenit 8 dhe 14 të Ligjit për Organizimin dhe Funksonimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura të Republikës së Kosovës Nr.06/L-113 (GZ, Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ, Nr.20/12 qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, (përditësuar me vendimin Ref.932/22), Këshilli Shtetëror i Cilësisë, Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KShC), në mbledhjen e 115-të, të mbajtur më 25.08.2023, mori:

V E N D I M

- I. Refuzohet kërkesa e Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit në Universitetin e Prishtinës, Nr.Prot.834/23 e datës 19.06.2023, për lejim shtimit të numrit të studentëve në programin e sapo akredituar Edukim Fizik dhe Sport MA, 60 ECTS dhe shuarjen e programit Edukim Fizik dhe Sport MA, 120 ECTS:
- II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A R S Y E T I M

Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit në Universitetin e Prishtinës, më datë 19.06.2023 ka parashtuar kërkesë me Nr.Prot.834/23, për lejim shtimit të numrit të studentëve në programin e sapo akredituar Edukim Fizik dhe Sport MA, 60 ECTS dhe shuarjen e programit Edukim Fizik dhe Sport MA, 120 ECTS:

Të dhënat janë prezantuar në mbledhjen e KShC-së të mbajtur me 25 gusht 2023, dhe pas shqyrtimit të detajuar të kërkesës, verifikimit të dokumentacionit të programit të studimit, KShC mori vendim që të refuzoj kërkesën me arsyetimin se për të bërë ndryshimin e numrit të studentëve sipas kërkesës, duhet të zhvillohet procedurë e re e vlerësimit me ekspertë të jashtëm ndërkombëtarë.

Andaj KShC në përputhje me legjislacionin në fuqi, faktet e prezantuara dhe kompetencat ligjore, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike: *Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në organin kompetent në afatin prej 30 ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ.*

Vendimi iu dërgohet:

- Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit në Universitetin e Prishtinës;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.

Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

